



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-7162/23
Kaçanik, 22.03.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e III (tretë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 31 mars 2023 (e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 31.03.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga vitet paraprake, në buxhetin e komunës të vitit 2023;
3. Propozim Vendimi për miratimin e Iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;
4. Kërkesa e Antigona Axhami-Baftijaj, Fiknete Kransiqi, Edita Shehu, për dorëheqje nga pozita e anëtarit të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.60/01-4155/23
Kaçanik, 27.02.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 27 shkurt 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 – të gjithë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Sali Malsiu-DSHMS, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti- DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Hafize Sallahu-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri –Selimi, Bejtulla Dalloshi, Hidajete Guri, Shefket Koxha, Mavije Murseli.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti- zyrtar i lartë për monitorim të komunave në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, të gjithë janë prezentë, kushte pune për mbajtjen e mbledhjes ka, e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 27 shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022;
4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023;
5. Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022;
6. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022;
7. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022;
8. Propozim Vendimi për subvencionim të fermerëve;
9. Propozim Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Fillimisht iu njoftoj lidhur me Deklarimin e pasurisë. Nga data 01-31 mars 2023 duhet të deklaroni pasurinë, ndërkaq është hera e fundit që anëtarët e KK e deklarojnë pasurinë, për shkak të ndryshimit të ligjit. Kjo ishte kërkesë nga Kolegjiumi i kryesuesve të KK, që anëtarët e Kuvendit të Komunës të lirohen nga deklarimi i pasurisë, për shkak të kompetencave që kanë, se nuk lidhen direkt me çështje të korrupsionit. Jeni të vetëdijshëm për pasojat ligjore që na presin nëse nuk e deklarojmë pasurinë, kështu që të keni parasysh çështjen e deklarimit të pasurisë në afatin e përcaktuar ligjor.

Për shkak të volumit të materialit, kërkoj që diskutimet kur t'i bëni, mos i ndërhyri njëri tjetrit, që mos të krijojmë debat interaktiv mes dy personave, por t'i përmbahemi rregullores. Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendi e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi e punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, 31.01.2023 të datës 01Nr.60/01-2121/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Agim Mani: Unë nuk kam pyetje apo kërkesë, por kam një Ankesë lidhur me një pyetje të cilën e kam ngritur në muajin tetor, për të cilën nuk kam marrë përgjigje, e cila përgjigje po t'me ishte dhënë, na kishte shërbyer sot në këtë mbledhje.

z. Naim Beça: 1. Kërkoj nga organet përkatëse komunale të vendosë mbrojtëse për vetura në rrugë të rrezikshme, që mos të ndodhë aksident me fatalitet. Në vazhdim z. Beça i potencoj aksidentet e ndodhura kohëve të fundit në rrugë të rrezikshme (Llanishtë) me të lënduar të 3-4 persona, në mesin e të cilëve edhe një familjar.

2. Pyetje e dytë është për drejtorin e DSHMS: Ku është arsyeja që vetëm deri në ora 15:00 veturat parkohen në parkingun e ambulancës, ndërkaj me ka rastisur me i parë vetura që vijnë nga terreni pas orës 15:00 ndalen me larg nga ambulanca, paguajnë parking me para, shpesh edhe dënohen në mungesë parkingu. Këtë nuk e kuptoj, kur dihet se ambulanca punon deri në ora 20:00, ndërkaj parkingu mbyllet në ora 15:00.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pajtohem me ankesën e kolegut Agim Mani. Unë në mbledhjen e kaluar kryetarit iu kam drejtuar me një pyetje, kaluan një muaj dhe nuk kam përgjigje.

1. E kam një pyetje për drejtorin e DSHPE: Mungesa e ngadalësuesve të shpejtësisë në afërsi të shkollave, mungesa e sinjalizuesve horizontal dhe vertikal në afërsi të shkollave, trotuari i shndërruar në formë parkingu dhe dalja direkt në rrugë e nxënësve nga shkolla të SHF "Emin Duraku" në Kaçanik, cenon lirinë dhe sigurinë e fëmijëve dhe kjo mbetet ende problem në komunën tonë. Nëse mundesh drejtor me na shpjeguar: A janë të pajisura të gjitha rrugët në afërsi të shkollave me sinjalizues ?

z. Betim Shala: Pyetje për Kryetarin e Komunës: A ka diçka lidhur me nënkalimin prej rrugës "Skënderbeu" deri të "ETC" të pjesa ku kalojnë fëmijët me shkuar në shkollë ?

z. Agim Çaka: Në këtë mbledhje do t'i paraqes disa çështje të cilat janë në interes të qytetarëve:

1. Ndriçimi publik, nuk është funksional në pjesën me të madhe të qytetit, me saktësisht, të Kalaja, të Ura e Konakut dhe një pjesë të rrugës së Rakocit deri të lagjja Lika.

2. Të projekti i ndërtimit të hekurudhës, ka ankesa të qytetarëve, sepse gjatë punimit të hekurudhës është ngushtuar rruga, me çka është vështirësuar kalimi me makina. Janë vendosur disa mbrojtëse të betonit të cilat mendoj se janë jashtë standardeve të mbrojtjes së rrugës dhe

të këmbësorëve që kalojnë atypari. Makinat duke ia lëshuar rrugën njëra tjetrën, ka rrezik me përfunduar në hekurudhë. A do të ketë mbikalime apo nënkalime në dy pozicione të hekurudhës, të Kalaja dhe të pjesa e rrugës që vazhdon për të shkolla?

3. Po flitet për dështimin e projektit të asfaltimit të rrugës: Runjevë-Stagovë. Sa është e vërtetë kjo, në mënyrë që t'i informojmë qytetarët se ku qëndron problemi, i qeverisë apo i nivelit lokal?

4. Lidhur me rastin e tërmetit i cili ndodhë para do ditëve në Turqi: Cilat janë mundësitë që komuna me ndihmuar në këtë drejtim? Një donacion simbolik kishte me qenë i mirëpritur për të gjitha ata që kanë përjetuar këtë ngjarje në njerëz dhe dëme materiale.

z. Ekrem Livoreka: Kam një kërkesë për DSHPE, Ramadush Osmani: Me kërkesë të banorëve të fshatrave; Gajre-Ivajë-Strazhë, në hyrje të rrugës, Gajre, kërkoj të vendoset një shenjë orientuese me emrat e fshatrave, për me bërë orientimin e qytetarëve me të lehtë në atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën vijuese:

2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Sa i përket Raportit të Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022, ne konsiderojmë se është i pasaktë, jo transparent dhe jo llogaridhënës. Pse i pasaktë? Në fillim të raportit të Qendra komunale për shërbime me qytetarë, tabela të cilin ju e prezantoni është plotësisht e pasaktë, ju thoni: “Gjatë vitit 2022, në sektorin e Shërbimit me qytetarë janë pranuar, proceduar dhe përfunduar 33961 lëndë”, ndërsa ne themi është gabim në bazë të shifrave që ju i prezantoni në të njëjtin tabelë, sepse po t'i mbledhim me saktësi dalin 33675 lëndë, dhe jo vetëm kjo pasaktësi, të gjitha shifrat për secilën drejtori veç e veç janë të pasakta, pra raporti është i pasaktë. Jo transparent -mungesa e numrave të fletëve (faqeve) në një raport njëvjeçar kaq voluminoz të ekzekutivit, e bënë jo transparent dhe vështirë me komentua raportin. Dy, shumicës së Drejtorive komunale ju mungojnë shumat (kostot) e projekteve të realizuara. Dhe tre, pjesa e tabela nga Zyra e prokurimit është e deformuar apo në radhitje e çrregulluar me, emërtimin e projektit, vlerën e parashikuar me buxhet dhe vlerën e kontraktuar të projektit. Jo llogaridhënës -si mund të jepni llogari para publikut kur jeni të pasaktë dhe jo transparent, pra si mund të diskutojmë dhe t'i besojmë një raporti që është kaq jo transparent dhe i pa saktë. Kolegë të nderuar, për të vërtetuar këtë, ne kemi edhe fakte tjera. Si është e mundur që Kontrata e njëjtë për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale të na dalë me çmime të ndryshme në 3 raporte të ndryshme. Në Raportin e Ekzekutivit del 201,425 €, në Raportin vjetor financiar 212,263€, ndërsa në Raportin nëntë mujor financiar na del më shtrenjtë se në raportin vjetor, pra na del shuma 226,910 €, ju lutem më thoni si është e mundur kjo. Ja edhe një fakt tjetër, bazuar në pjesën e raportit të DKA-së transporti i nxënësve kushton 8,000€ në muaj, dhe unë po them shumëzuar për 10 muaj që nuk janë, por hajde të themi se janë, kushtojnë 80,000 € në vit, ndërsa në pjesën e raportit të prokurimit e kemi vlerën e parashikuar të kontratave për transportin e nxënësveve 209,480€, ndërsa vlerën e kontratave së bashku e kemi 182,682 €, do të thotë, më tepër se 100.000 € më shtrenjtë. Si është e mundur kjo?

Dhe për fund, e kam edhe një pyetje për Ekzekutivin, kushdo që mund t'me tregojë, ku gjendet Strehimorja nëntokësore në Gjimnazin “Skënderbeu”, sepse kam pyetur shumë njerëz që mund ta dinë, por askush nuk e dinte.

z. Agim Mani: Do të mundohem me bërë një përmbledhje tjetër në krahasim me më atë që e bëri kolegu im. Janë të vërteta këto që i tha kolegu, ndërkaq në këtë Raport të Ekzekutivit ka diskriminim, si të ndriçimi publik, buxheti total i komunës 30% ka shkuar në Kaçanik të Vjetër. Në këtë rast ka fshatra e lagje të cilat nuk kanë fare ndriçim publik, ndërkaq në Kaçanik të Vjetër është kryer edhe faza e tretë. Të ndriçimi publik e pashë edhe një shkrim, ku Ekzekutivi i komunës ka lëshuar pëlqim dhe mburret me atë që disa lagje e fshatra vetëfinancojnë

ndriçimin publik. Kjo i bien se qytetarët e kanë humbur shpresën të komuna, ndërkaq komuna edhe pse e ka buxhetin, mjetet po i kthen prapa. Drejtori i ka dhënë statistika, por nuk ka dhënë statistika sa metra katror asfalt janë asfaltuar dhe në cilat projekte rrugore. Për këtë kërkoj nga DUKMM me na dhënë tani informata me emër, sa sipërfaqe me asfalt janë shtruar në secilin projekt rrugor.

znj. Fitore Vishi: Marrë parasysh vështirësitë dhe problematikat, objektivat gjatë vitit që lamë pas, mund të konstatojmë se realizimi i objektivave që kishim në planin e punës së Ekzekutivit të komunës të vitit 2022 janë realizuar. Ne si grup parlamentar i PDK vlerësojmë për vitin që lamë pas, përkundër situatës emergjente, janë përmbushur objektivat investive dhe zhvillimore në komunën tonë. Jemi të vetëdijshëm se projektet tjera na presin, por me dinamikën dhe seriozitetin të cilin e kemi përpara, çdo objektivë do të përmbushim brenda dinamikës dhe afateve të caktuara ligjore.

z. Rrustem Zenuni: Lidhur me numrin e lëndëve që u potencua se janë llogaritur gabim, unë bëra përlllogaritje dhe shifrat me dalin të sakta. Me intereson të di, qysh e keni bërë llogaritjen që iu kanë dalë tjera shifra?

z. Adnan Reka: Llogaritja: lëndë të pranuar, $224 + 2940 + 12577 + 488 + 17446 = 33675$.

Të DZHT, 1 lëndë e pranuar, 12 në proces, 30 të miratuara, 5 të refuzuara, 2 të përfunduara = 52, ndërkaq numri i saktë është 50 lëndë.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Nga raporti i cili është paraqitur nga Qendra komunale në shërbim me qytetarë, ekziston sistemi i intranetit, ku kemi edhe ne qasje në atë sistem. Në këtë kategori, nuk mund të shihen lëndët të cilat janë hedhur poshtë, pezulluar, refuzuar dhe anuluar, e që e japin shifrën 33961 lëndët e miratuara.

z. Adnan Reka: Unë nuk e di çka ka menduar drejtoreshë, unë po e shoh totalin e lëndëve. Unë i referohem të dhënave në raport të cilat i keni paraqitur, e që të dhënat nëse i mbledhim, totali nuk përputhet me shifrën e paraqitur në asnjë drejtori, ajo mund të jetë ashtu, por për ne me i paraqitur të dhënat kështu në raport, nuk ka kuptim.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Kjo është argumentim, se unë qasjen të cilën e kam në intranet është kështu, ndërkaq me qasjen edhe të dhënave të zyrtarëve në shërbimet tjera, ne arrijmë me i ditur edhe kategoritë tjera.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne flasim për të dhënat të cilat i shohim, se mund të jenë ashtu drejtoreshë, por ne iu referohemi të dhënave të paraqitura në raport.

z. Agim Çaka: Është e vërtetë se në tabela ka gabime dhe mospërputhshmëri në numra, kam vërejtje edhe të drejtoresha, se ne veprojmë në bazë të numrave. Kur të përpilohet një tabelë, shifrat duhet të përputhen në formë vertikale dhe horizontale. Kur jepet një e dhënë gabim, atëherë ai gabim përcjellët në krejt totalin e shumës, kështu që pajtohem me Adnanin lidhur me vërejtjet të cilat i theksoj.

znj. Ardita Rrahmani: Duke diskutuar këtë raport pune, shohim një diskrepancë të madhe në mes planit të aprovuar për vitin 2022 dhe këtij raporti. Duke e parë këtë raport, po ndërlidhem me një kërkesë të cilën nuk kam marrë përgjigje. Nuk është shënuar donacioni i EULEX për veturën e dhuruar QKMF, ndërkaq janë përfshirë donacionet tjera, përfshirë edhe do ampula. Pse po e fshihni këtë? Në plan është shënuar se, do të bëhet dezinfektimi dhe dezinfektimi dhe deratizimi, a është realizuar, sa ka kushtuar dhe ku është realizuar. Gjithashtu thuhet se është arritur një kontratë për shpërndarjen e disa pampersave nga një kompani. Unë në kontakt me ata të QKMF kam kuptuar se kjo nuk është realizuar.

z. Ramadush Osmani: Raporti është i hartuar goxha mirë, të mirëmbajtja e rrugëve dimërore dhe verore, e kam cekur situacionin për punët të cilat janë realizuar në vitin 2022. Prejren buxhetore e sqaron drejtori i DBF, se kjo mund të dallon, se mund të paguhen edhe borgjet e

vitit të kaluar. Këto shuma të cilat i kam paraqitur, janë shifra të sakta për punët të cilat janë bërë në vitin 2022, ndërkaq pjesa tjetër që janë 12,000€ me tepër e sqaroj drejtori i financave se mund të jenë bërë prerje të ndryshme. Adnani pyeti, a ka strehimore të SHM “Skënderbeu”, strehimore ka, mund të vizitoni, është nën SHM “Skënderbeu”, është me të gjitha standarden që duhet t’i ketë një strehimore për numrin që e kemi cekur. Të ndriçimi publik, e kam cekur edhe në KPF, DSHPE prioritet i ka rrugët lokale dhe lokaliteti varësisht nga gjatësia e rrugës aq ka edhe investime. Në Kaçanik të Vjetër janë rrugët “Epopeja e UÇK dhe “Komandant Bardhi” dhe është faza e 3 se rruga Komandant Bardhi është vazhduar nga hekurudha në drejtim të Begracës, që është pjesë e prioritetëve të komunës për rrugët kryesore. Vetëfinancimi- është një formë që duhet të mburremi, këtë e praktikojmë se nuk mund të bëjmë investime në rrugë sekondare para atyre primare. Ka komunitet që shprehin gatishmërinë me kryer vet ndriçimin publik, pastaj drejtoria me marrë në menaxhim mirëmbajtjen mujore të ndriçimit publik, ku duhet bëhet një kërkesë, caktohen kriteret, del komisioni i verifikon se a është realizuar projekti në pajtim me kriteret e përcaktuara. Të pyetja, sa metra gjatësi rrugë janë asfaltuar, të dhënat janë në DUKMM.

z. Adnan Reka: Faleminderit për sqarimin për çështjen e strehimores. Unë nuk e kam ditur që ka strehimore, nëse mundesh me na treguar drejtor nga e ka hyrjen strehimorja? Sa i përket shumës 201,425 €, unë nuk ke di çka keni shpenzuar, ndërkaq raporti vjetor financiar thotë ndryshe, raporti 9 mujor financiar thotë ndryshe, bile raporti 9 mujor jep shumë me të madhe se raporti vjetor. Këto të dhëna janë në sh përputhje të madhe.

z. Agim Mani: Po me duket drejtor se i keni përzier kompetencat me DUKMM. Për trotuar ju i keni dhënë në raport shifrat, ndërkaq për rrugë, nuk kam parë askund në raportin e ekzekutivit. Pyetja ime është për DUKMM: Sa sipërfaqe rrugë janë shtruar në secilin projekt të asfaltimit të rrugëve ?

z. Ramadush Osmani: Hyrja e strehimores është nga pjesa e brendshme e gjimnazit, e ka daljen emergjente në formë të tunelit që del në oborr. Ne kemi dashur me qenë shumë transparent, se nuk ka nevojë shifra me potencuar në raportin e ekzekutivit, ato potencohen në raportin financiar, prerja buxhetore dallon, që mund të sqaroj drejtori. Trotualet, janë kodet dhe emërtimet e projekteve në secilën drejtori. E kam potencuar, ndërtimin e trotuarit në Gabrricë, Gërllicë, Stagovë, ndërkaq ndërtimi i rrugëve lokale në zonë urbane dhe rurale janë në DUKMM të cilat janë të prezantuara të kjo drejtori.

z. Agim Mani: Unë këtë pyetje nuk po e bëjë sot e kam bërë para 2 muajve, përgjigje nuk kam marrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Të dhënat për asfaltim të rrugëve në metër gjatësi janë në raportin financiar.

z. Agim Mani: Mos t’i përziejme çështjet me raportin financiar. Në Raportin financiar nuk është paraqitur sipërfaqja e rrugëve të asfaltuara.

z. Adnan Reka: Nëse ka mundësi drejtor (drejtorit të DA) me na dhënë sqarime të nevojshme lidhur me transportin e nxënësve ?

z. Zahir Doda: Raporti i ekzekutivi nëse krahasohet me raportin financiar, del diçka tjetër, shifrat dallojnë, se unë aty i kam sqaruar vetëm 2 pozicione. Shifrat 3,000€ dhe 5,000€ nuk munden me qenë ashtu të plota, por unë kam sqaruar vetëm për Voskopojen, 3,000€, se kjo ndryshon çdo muaj, mundet me qenë shuma 300-400€ plus minus. Unë e kam përmendur për transportin obligativ të nxënësve për shkollat të cilat janë mbyllur, ndërsa ka edhe shumë pagesa tjera që paraqitën të raporti financiar, p.sh. operatori i Gjilanit që bënë bartjen e nxënësve me nevoja të veçanta për Prizren, Prishtinë është kontrata të cilën nuk i di shumën. Subvencionimi i transportit në zona me të larta, Gllloboçicë, Strazhë, shuma rritet, kështu që nuk mund të krahasohen këto 2 raporte të punës mes veti.

z. Adnan Reka: Në raportin e prokurimit është paraqitur transporti i nxënësve 2022/2023, 100,000€, ndërkaq ju nuk jeni në dijeni, ndërkaq tani me arsyetuar diçka që nuk është paraqitur fare në raport, nuk e di sesa është e arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk duhet të nënvlerësoar arsyetimin e askujt, megjithatë drejtori u mundua me dhënë sqarime, nëse të intereson rrjedhja e parasë është e sqaruar në raport, drejtori është këtu për sqarime. Diskutime tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-4102/23.

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Sipas këtij raporti, buxheti fillestar ka qenë 9,193,167.00€, ndërkaq buxheti final 9,994,256.43€. Fillimisht bëhet planifikimi, pastaj bëhet ndarja e mjeteve në kategori të caktuara buxhetore, në fund realizimi. Përveç granteve, planifikimi bëhet edhe për të hyrat vetanake komunale-HVK. Të HVK janë 8,975,661.04€ mirëpo planifikimi ka pësuar ndryshime janar-shtator me janar-dhjetor. Të HVK raporti vjetor ka ndryshim me raportin 9 mujor të TM1, TM 2 dhe TM 3. Planifikimi bëhet në fillim të vitit, por nuk mund të realizohet dhe ndryshohet për me ardhur në rregull përqindja e realizimit. Ka edhe gabime në kalkulim, të DSHPE, nuk duhet të jetë 3,500€, por 13,500€, të Kadastrit 132,000€, por duhet të jetë 130,266€, të Administrata nuk duhet të jetë 14,308€, por 11,350€. Të te hyrat indirekte të raporti vjetor nuk keni planifikuar fare, ndërkaq kanë qenë të planifikuara në raportin 9 mujor TM1, TM 2 dhe TM 3 61777€. Gjatë vitit 2022 janë realizuar 890,078€ të HVK, që është në rregull + bartja e mjeteve nga viti i kaluar, 1,596,318€, të cilat mjete nuk kanë arritur të realizohen as 50%. A keni planifikuar bartje të mjeteve të vitit 2021 apo vetëm të vitit 2022, se keni planifikuar bartjen e mjeteve vetëm të atyre të vitit 2022. Të shpenzimet të MSH, fillimisht ka qenë një kontratë e cila është kontraktuar në vlerë 170,000€ dy vjeçare për mirëmbajtjen e nxehjes, druve, sigurisht se planifikimi ka qenë i keq, se është dashur në dhjetor 2022 me lidhur një kontratë tjetër, 190,000€. Kur të kalkulohet kjo kontratë, del se janë kontraktuar mbi 4000 metra kub dru. Kërkesat mund të rriten, por jo në shumën e caktuar. Të mirëmbajtja e rrugëve që e ceku edhe Adnani me herët, në raportin e ekzekutivit thuhet se janë 210,226 mijë në raportin 9 mujor, në raportin vjetor 201 mijë. Ka edhe paqartësi tjera. Të raporti i realizimit të projekteve kapitale, bashkëfinancimi i projekteve, 80 mijë euro, në cilin projekt janë shpenzuar këto mjete. Të rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane dhe rurale, janë mbi 294 mijë euro, ndërsa të shpenzimet kapitale thuhet se janë shpenzuar 450 mijë euro në rrugë lokale. Ku janë mjetet tjera të cilat ne nuk i shohim, nuk janë transparente. Po të bëjë këtë pyetje drejtor, se kësaj here, raporti ka qenë me ndryshe i hartuar dhe me i komplikuar me kuptuar. Të suficitit e kam bërë një pyetje në KPF dhe ju keni thënë se janë në suficit 93 mijë euro prej grantit, ndërkaq në këto tabela thuhet diçka tjetër, varianti është 1 milion e njëqind e tetëmbëdhjetë. Nga kjo hiqen të HVK të cilat mund të barten, ndërkaq mjetet tjera nuk mund të barten, dhe suficitit del 203 mijë euro.

znj. Ardita Rrahmani: Janë mbi 99,375€ nga Granti qeveritar dhe 121,341€ të hyrat direkte suficit buxhetor. LDK në raportin 9 mujor ka shprehë këtë shqetësim, dhe ky shqetësim po vërtetohet. Ku është arsyeja që po ndodhë kjo, a është nga mosdija apo pse po ndodhë?

z. Bashkim Luma: Unë në disa mbledhje kam bërë kërkesë lidhur me vlerën e projekteve në f. Gllloboqicë. Përgjigja e drejtorit ka qenë se vlerat do të paraqiten në raportin financiar, mirëpo edhe në këtë raport financiar, nuk është përfshirë vlera e projekteve. Cila është arsyeja ?

z. Bahri Selimi: U debatua për disa diferenca të buxhetit, realizimi raportit financiar dhe raportit të ekzekutivit. Raporti i ekzekutivit krahasohet me planin e ekzekutivit, e jo raportit të

ekzekutivit dhe realizimit të buxhetit, kjo është qasje gabim. Edhe Ardita shumë mirë e tha në fillim, raporti i ekzekutivit krahasohet me planin e ekzekutivit. Raporti financiar, nëse qytetari donë me ditur saktë se si është realizuar secili mjet i buxhetit, është raporti financiar, e elaboroj pak edhe drejtori i DA. Ajo që planifikohet në planin e ekzekutivit, shkon në terma, ndërsa në terma financiar në masë monetare është raporti financiar. Prokurimi i evidenton kontratat në raportin e vet, kontratat mundën me u lidhur me shuma të mëdha, ndërkaq mundet gjatë vitit mos me u shpenzuar asnjë cent. Ndërsa, për pyetjet të cilat i bëri Agimi, se sa mjete janë shpenzuar për projekte të caktuara, etj., ishin pyetje me vend. Të planifikimi i të hyrave, Agim keni të drejtë se kemi pasur një gabim teknik, mirëpo në mes tremujor shit të dytë, tretë dhe këtij final, unë po të pyes sa kemi pasur planifikimin në total? Kemi pasur një ndryshim të kjo shifra 689.430€, ky është planifikimi vjetor final vjetor i të gjitha llojeve të HVK. Nëse ka pasur në mes të hyrave ndonjë dallim apo ndonjë korrigjim gjatë vitit. ajo lejohet. Përpos këtyre sqarimeve, po e shoh se ka nevojë me iu dërguar edhe sqarime tjera me email. Të krahasimi të MSH që bëre Agim, këto janë dru për nxehje, 190,206 i kemi shpenzuar në vitin 2022, 99,509 në vitin 2021, këtu hynë edhe shpenzimi me peletë, dihet se peleti ka lëvizur shumë çmimi nga ajo e kontraktuar në vitin 2022. Të bashkëfinancimi, 80.000€, shpenzimi ka shkuar për objektin e zjarrfikësve, në Kovaçec, objekt i ri i cili po ndërtohet tani. Të rrugët lokale, pjesa e parë e raportit financiar, nuk e kemi obligim me ua dërguar juve, e kemi dërguar si shtesë, për dallim nga ky raporti që e kemi dërguar në ministri- raporti standard. Të raportit standard, të rrugët të cilat i përmende, kategorizohen sa janë kanalizime, sa ujësjellës, trotuare, sa janë rrugë, ndërkaq të raportit detaj, janë rrugët e klasifikuara me emër. Nuk janë shpenzuar vetëm 240 mijë në rrugë lokale, ka me shumë, janë rrugë me emra dhe dalin si kategorizim aty rrugë lokale dhe rrugë urbane. Të pyetja e Ardites, të suficitit dhe të te HVK, unë kam përmendur të HVK nuk ka asnjë sqarim tjetër, edhe vitin e kaluar kur kemi pasur tejkalim të HVK kemi pasur për shkak të lejeve të ndërtimit. Sivjet nuk ka pasur ndonjë ndërtim të objekteve të reja banesore, nuk ka pasur ndonjë pagesë, zakonisht lejet e ndërtimit të objektet e larta të banimit shkojnë deri në 100.000 €, kjo diferencë është për 120.000€ me pak inkasimi. Përformancë të mirë kemi të tatimi në pronë, të lejet e ndërtimit nuk kemi sivjet sikur komunat tjera. Të suficitit, nuk e di a kemi arsye të flasim për suficit, duke ditur suficitin e nivelit qendror, ne jemi më mirë se çdo organizatë tjetër buxhetore, mundeni me kontaktuar me komunat tjera dhe me ditur suficitin buxhetor. Vit stagnues ka qenë, vit i inflacionit, vit i rënies ekonomike, dhe me gjitha ato projekte, kemi me arritur suficit vetëm 93.000€. Ngecje kemi pasur në 2 projekte, Çarshisë së qytetit, kjo për shkak të një shtylle të KEDS, dhe të projekti, Ndërtimi i objektit të ri për banim social, se kontrata është lidhur me 18 tetor, ka dështuar kontrata deri është lidhur 3 herë, për shkak të operatorëve, OSHP që funksionon në kuadër të qeverisë nuk ka funksionuar tërë vitin, e kështu me radhë. Të HVK janë diku 820.000€ të cilat kanë me u bartë në këtë vit dhe me i shpenzuar aty ku duhet. Të pyetja e Bashkimi, do të mundohem me ia dërguar të dhënat me email.

znj. Ardita Rrahmani: Unë jam anëtare e këtij kuvendi dhe flas për interesat e qytetarëve të kësaj komune, ndërkaq për interesa dhe suficit të komunave tjera, ata i kanë përfaqësuesit e tyre secila komunë, kështu që arsyetimi që u dha, nuk është në kompetencë të komunës tonë.

z. Rustem Zenuni: Normale është me qenë brengosesh për suficitin e ngelur buxhetor, 93,000€ por ne duhet me bërë krahasime edhe me komunat tjera, se janë disa faktorë që kanë ndikuar, si mosfunksionimi i OSHP që lidhet direkt me kontratat që u përmend me herët nga drejtori. Nëse shikojmë komunën e Shtimes, ajo është me keq se ne, me suficit buxhetor, 1 milion e 400 mijë euro. Komuna jonë pavarësisht vështirësive financiare të cilat janë paraqitur, problemeve me OSHP, ka arritur mirë në shpenzimin e buxhetit, që mos të kemi shumë mjete të mbetura në suficit buxhetor.

z. Betim Shala: Unë i themi drejtorit të DBF se nuk ka nevojë me bërë krahasime me komunat tjera, se mundemi me bërë krahasime në mes të drejtorive të komunës tonë. Fjala vjen DBF i ka rritur të HVK në krahasim me vitin e kaluar, inspektorati i ka rritur të hyrat në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkaq DSHPE e cila ka pasur me tepër punët në terren, i ka shpenzuar të gjitha

mjetet, kështu që krahasimi para se të bëhet me komunat tjera, të bëhet këtu në mes të drejtorive komunale.

z. Agim Mani: Të asfaltimi i rrugëve urbane dhe atyre rurale, kanë qenë dy projekte për të cilat janë kryer procedurat e prokurimit, 275.000€ , shtuar me vonë edhe 10% që ka të drejtë dhe ka arritur 294.000€, kjo është e cekur në raportin financiar. Ndërkaq projekti tjetër, 124.615€, nuk e pash a ka përfunduar, a janë dhënë mjetet për tre rrugë: “Rabit Dullovi”, “Shaban Elezi”, “Regjep Luzha” dhe Ndërtimi i murit mbrojtës në Kovaçec, procedurat prokurimi i ka kryer me 20.09.2022, kontratat nuk janë bërë transparente, vendimin e kemi që kontrata është nënshkruar, mjete janë ndarë, ndërkaq çështja është se a janë shpenzuar ato mjete.

z. Bahri Selimi: Të gjitha mjetet që janë shpenzuar, janë paraqitur në raportin financiar, ndërkaq mos u bazoni në raportin e ekzekutivit, por në atë financiar për shpenzimin e mjeteve buxhetore.

z. Agim Mani: Në raport financiar nuk janë paraqitur këto shpenzime 124.615€.

z. Qamil Stagova: Desha me sqaruar për projektin 124.000€, është fjala për asfaltimin e një rruge në Biçec, një në Sllatinë dhe nuk janë paguar krejt mjetet, kanë me u paguar edhe 51.000€ që janë punë shtesë.

z. Adnan Reka: U diskutua shumë, por unë ende nuk e kuptova sa është suficiti buxhetor me gjithë sqarimet të cilat u dhanë. Ne po kërkojmë me ditur sa është suficiti i përgjithshëm buxhetor, e jo sa është suficiti vetëm për investime kapitale. E kemi të qartë drejtor se ju i bartni 814,622€, prej mjeteve 1,18985€ të cilat iu kanë mbetur pa realizuar. Nga këto mjete shuma e bartjes është 814,622€ nga vitet paraprake, këto rikthehen në buxhet, kjo është e qartë, ndërsa mbetin mbi 200,000€. A janë këto mjete suficit buxhetor?

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtor të jemi të qartë për vlerën totale të suficitit buxhetor, duke ia hequr të HVK. A është e saktë vlera që u prezantuar 93.000€ e mjeteve në suficit buxhetor?

z. Bahri Selimi: Në raport gjithçka që është e shënuar është e saktë, është edhe shpalosja, kërkoj të lexoni edhe shpalosjen.

z. Adnan Reka: E kemi lexuar drejtor shpalosjen. Sipas neve, suficiti buxhetor është 203.973€, nuk po e kam të qartë se ju nuk po e thoni. Ju na thatë që raporti i ekzekutivit nuk duhet të krahasohet me raportin financiar, por raporti financiar me raportin financiar, a mund të krahasohet? Në raportin financiar të mirëmbajtja e rrugëve, muajin e 9 është shuma me e madhe sesa shuma në fund të vitit. Në muajin e nëntë është 226.910€, në fund të vitit është 212.262€.

z. Bashkim Luma: Nuk mora përgjigje në kërkesën time.

z. Ramadush Osmani: Lidhur me kërkesën e Bashkim Luma, ia dërgoj në email përgjigjen.

z. Bahri Selimi: Kam dhënë shumë shpalosje shtesë, është raporti standard, megjithatë edhe njëherë do të ua dërgoj me email. Nuk e kam me veti raportin nëntëmuor financiar, i bëjë krahasimet dhe ua kthej përgjigjen në email, se nëse kanë dalë me tepër mjete në raportin nëntëmuor financiar, është gabim. Raporti vjetor financiar paraqet gjendjen e fundit.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,
NJOFTOHET

Me Raportin Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022 / Lënda: 01Nr. 05-400/01-4131/23.

4. Informatë për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka: Sa i përket, Informatës për përfundimin e Gjysmëvjektorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023 si dokument, unë vërtet e pranoj se është dokument i qartë, i saktë dhe transparent, dhe jo vetëm kaq. Unë dua ta pranoj edhe publikisht se që nga prezantimi juaj i parë në legjislaturën e kaluar kur prezantuat Informatën e DKA-së të cilën ju nuk e përpiluat, por e trashëguat nga pararendësi juaj, patët thënë, ju citoj: “Me vjen keq që duhet të flasë për një dokument të cilin nuk e kam shkruar, por është i nënshkruar nga unë dhe më duhet ta pranoj, por, zotohem se kurrë më nuk do të shihni një dokument të tillë të nënshkruar nga unë” dhe ju vërtet e keni mbajtur fjalën, për çfarë ju përgëzoj. Përkundër kësaj, unë nuk pajtohem me politikat e Drejtorisë që udhëhiqni ju. Pse nuk pajtohem me politikat menagjeriale të drejtorisë tuaj? Sepse po të flasim për infrastrukturën shkollore, nuk është se duhet të ndjeheni komod, keni shkollën “Emin Duraku” në gjendje të mjerueshme, shkollën e Kovaçecit që ka filluar punën para 3 vitesh, por që asnjëherë nuk keni arritur ta përfundoj as rrjedhjen e çatisë e as ngrohjen ashtu si duhet për nxënës, për shkak të aferave korruptive që tanimë të gjithë i dinë për atë shkollë. Ju rrënuat institucionin e vetëm parashkollor në komunë, me kushte optimale për nevojat e komunitetit për të ndërtuar një institucion tjetër parashkollor, 50 metra nga objekti paraprak, pa oborr, me hyrje shumë më të vështirë për të realizuar qëllimet djallëzore të klanit. Nuk mund ta konsideroni sukses as personelin menaxherial të shkollave, keni drejtor të shkollave që i keni trashëguar dhe nuk keni mund t’i zëvendësoni, kanë pozitat e njëjta mbi një dekadë, keni drejtor tjerë me përkatësi plotësisht partiake, e në anën tjetër keni edhe shumë të tjerë që ushtrojnë detyrën e drejtorëve për vite me radhë. As cilësia në procesin mësimor nuk është më e mirë, nga viti 2018 kemi pasur rënie të vazhdueshme në cilësinë e arsimit.

Kalueshmëria e nxënësve ndër vite në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI –IX) ishte me sa vijon: në vitin 2016, 56.38%, në vitin 2017, 46.37% në vitin 2018, 52,70 %, 2019, 49,84 %, 2020 pandemi, 2021, 47,96 %, 2022, 43,48 % Meqë kemi përfundimin e Gjysmëvjektorit të Parë ne kemi krahasuar notën mesatare të nxënës nga klasa VI -IX me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vitin e kaluar nota mesatare ishte 3.56, ndërsa këtë gjysmëvjektor është 3.53.

z. Agim Mani: Drejtorët e shkollave të cilët janë ushtrues detyre, kam një pyetje. Sa shkolla funksionojnë drejtorët me ushtrues detyre, dhe a kanë të drejtë me vite të jenë ushtrues detyre drejtorët e shkollave. Pse nuk hapet konkursi për drejtor të shkollave në ato shkolla që funksionojnë drejtorët me u.d., së kështu e parasheh edhe ligji.

z. Bashkim Luma: Kur jemi të Informata e DA e këtij viti shkollor, po e ndërlidhi me 4 pika:

1. Sa i përket përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023, kjo drejtori ka planifikuar që në gjimnazin “Skënderbeu” të regjistrohen 256 nxënës, ndërkaq janë regjistruar 176 nxënës, një dallim prej 80 nxënës me pak të regjistruar. Në SHMP “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, 264 të planifikuar për regjistrim, ndërkaq janë regjistruar 160 nxënës, një diferencë shumë e theksuar në mes planifikimit dhe regjistrimit. Çka mundesh drejtor me na thënë për këtë diferencë në mes të planifikimit dhe regjistrimit?

2. Çështja e donacioneve të ndryshme. E di së në f. Glloboçicë ka pasur një donacion disa kompjuter të dhuruar për shkollën e fshatit, ndërkaq në këtë dokument nuk është përmendur një donacion i tillë. Ku është arsyeja që nuk është evidentuar ky donacion?

3. Transporti i nxënësve, që sipas mendimit tim është një problematikë në veti, dhe një padrejtësi që iu bëhet nxënësve të komunës tonë, kryesisht atyre që janë pjesë e gjimnazit “Skënderbeu”, për shkak të mbështetjes jo të barabartë në raport me pjesën tjetër të nxënësve në kuadër të pagesës së transportit. Ju si ekzekutiv i komunës duhet të krijoni kushte të barabarta për të gjithë nxënësit të komunës, e më pastaj mund të krijoni kushte apo kriteret tjera të cilat mund të llogariten si strategji për regjistrim të nxënësve për njërin shkollë apo tjetrën e jo përmes konkurrencës së mirëfilltë, apo mundin e tyre. Nëse i krahasojmë mungesat me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shohim se ka një diferencë bukur e madhe. Në vitin 2021 29875 mungesa gjithsej, 24.94 % e mungesave i takojnë 15390 mungesa janë të SHMP. Fillimin e vitit 2022/2023 kemi shifra të ndryshme, nga 26 mijë mungesa 14mijë janë të

gjimnazit “Skënderbeu”, kurse 12 mijë janë të SHMP “ Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” është dallim i madh i mungesave krahasuar me vitin paraprak të SHMP të liruar komplet nga pagesa e udhëtimit. Një dështim sipas mendimit tim të lirimit të pagesave të udhëtimit të nxënësve të kësaj shkolle. Kërkoj që në mbledhjen e radhës të vendoset që të lirohen nga shpenzimet e udhëtimit edhe nxënësit të cilët janë pjesë e gjimnazit “ Skënderbeu”.

4. Rezultatet jo të kënaqshme kur flasim për suksesin dhe mungesat të arsimtarëve dhe të nxënësve. Përgjegjës kryesor i mos suksesit për kundër trajnimeve të ndryshme që janë mbajtur për ngritjen e kualitetit.

Çështja e bursave, unë qysh në vitin e kaluar kam bërë kërkesë që të ndryshohet njëri nga kriteret e konkursit për bursat që i ndanë komuna. Si përgjigje ka qenë se kërkesa ime ka qenë shumë e arsyeshme, ndërkaq nuk është marrë parasysh kërkesa ime.

znj. Ardita Rrahmani: Marrë parasysh edhe nga kontakteve tona, e dimë se ka ushtrues detyre të drejtorëve në disa shkolla. Me intereson me ditur a keni marrë ndonjë veprim në këtë drejtim, sepse drejtorët e shkollave kanë të drejtë vetëm 6 muaj me ushtruar detyrën e drejtorit, ndërkaq ka drejtor që punon ushtrues detyre i drejtorit që dy vite.

z. Zahir Doda: E falënderoj Adnanin për informatën, pyetje nuk pati, por e bëri një përshkrim real, gjendja është e tillë, nuk kam as çka me hequr apo shtuar. Atë që e thatë ju, është faktike, kështu që jemi krejt në rregull. Reale është edhe gjendja e drejtorëve që punojnë u.d. disa janë me fajin tonë, disa pa fajin tonë, se është një procedurë për drejtorët që janë në pozita, sepse edhe ata të cilët i propozojmë me ua vazhduar mandatin, pa ardhur pëlqimi prej inspektorit të arsimit nuk mund t’ua vazhdojmë mandatin. Katër (4) drejtorë i kam u.d në pritje të rezultateve të inspektorëve të arsimit, ndërkaq në nivel regjional është vetëm një inspektor. Këtë sugjerim na i kanë dhënë edhe MASHT, në kontratë shkruhet i vazhdohet deri sa të vjen miratimi final nga inspektori i arsimit, se nuk ka të drejtë as kryetari i komunës me ia vazhduar kontratën pa ardhur miratimi final nga inspektori i arsimit. Për disa i kemi përsëritur konkuset, jeni dëshmitarë të asaj, në gjimnaz, ose nuk i plotësojnë kriteret ose nuk aplikojnë askush. Në çerdhe të fëmijëve, tri herë është anuluar konkursi se nuk ka pasur kandidatë. Për disa për u.d. kontrata bëhet për 6 muaj, mandej përsëritet edhe 1 herë në gjashtë muaj, kjo është duke ndodhur gjithkund në Kosovë. Të pyetjet që i parashtror Bashkimi, realisht unë mundohem me bërë planifikimin në bazë të numrit të nxënësve që e përfundojnë klasën e 9-të dhe unë atë planifikim e marrë bazë, mirëpo pjesa e Gllloboçicës, gjysma vijnë të ne, gjysma shkojnë në Tetovë, pjesa e Doganaj, Elezaj, Bajnicë, Begracë, 90% e tyre shkojnë në shkolla të Ferizajt, 10% vijnë të ne, ndërkaq nga Hani i Elezit një pjesë e nxënësve vijnë te ne. Unë jam munduar me planifikuar mbi bazën e theksuar, ndërkaq na mungon realizimi. Unë nuk guxoj me bërë planifikim nën shifrën e nxënësve që kryejnë klasën e 9, se ia mohoj të drejtën e shkollimit dikujt. Këta janë faktorët, ndërkaq nuk është defekt i drejtorisë, por planifikimi nuk mund të realizohet Të donacionet, regjistrohet si inventar, nuk me ka ardhur si regjistrim gjatë kohës kur e kam bërë informatën, përndryshe e di, jam i njoftuar me atë pjesë. Për çdo donacion, pasi të bëhet regjistrimi zyrtar si donacion, paraqitet në informatë, përndryshe jam i njoftuar me ata kompjuterë që kanë ardhur donacion. Të transporti, është politikë në nivel vendi, edhe MASHT jep bursa për shkolla profesionale, për shkak se tregu po i kërkon. Çështja që kemi ndarë bursa për SHMP me shumë kemi pasur mesazhe pozitive sesa kundërshtime, duhet përfillet me tepër mendimi i shumicës. Nëse në kalkulimet tona mbërrihet sikurse për Gllloboçicë, të gjithë nxënësit subvencionohen me gjysmën e biletës, qoftë në gjimnaz apo shkollë tjetër, edhe për Strazhë, sepse janë pika të larta. Edhe rastet sociale, ua kemi paguar 100% shpenzimet e udhëtimit. Ndërsa të çështja e bursave të studentëve që iu kemi ndarë studentëve brenda Republikës së Kosovës, ne mendojmë se vendimi është i drejtë, mund të mos jetë i drejtë, ky është mendimi im. Për pyetjen e Ardites, u përgjigja me herët, ne po tentojmë me i zgjedhur drejtorët e shkollave, por me koeficientet e caktuar ka me qenë shumë vështirë me i zgjedhë, sepse nuk ka me pasur të interesuar me aplikuar me i marrë ato përgjegjësi me koeficient të caktuar.

z. Bashkim Luma: Donacioni ka qenë para disa muajve dhe nuk besoj se zgjatë aq shumë një regjistrim i tillë. Për çështjen e pagesës së transportit e thatë që paguhet 100% për nxënësit e SHMP” Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” pse mos të bëhet kjo edhe për nxënësit e SHM “Skënderbeu” në Kaçanik?

z. Naim Beça: I kam dy pyetje: 1. Drejtorët të cilët janë ushtrues detyre të drejtorëve të shkollave: A keni bërë ndonjë analizë lidhur me efikasitetin e punës së tyre ? A janë efektiv dhe efikas dhe në kryerjen e detyrave u.d. të drejtorëve, si me qenë drejtorë të zgjedhur të shkollave?

2. Lidhur me konkurset e hapura për institucione arsimore, e potencove drejtor se nuk ka aplikuar askush të Çerdhja e fëmijëve QEAP “Agimi”. Cila është arsyeja që nuk ka pasur kandidat aplikantë ? Sa i përket koeficientit, vjet nuk ka qenë këta koeficiente. Cila është arsyeja që nuk kanë aplikuar kandidat për drejtor shkolle ? Ndoshta është dobësi e drejtorisë, se nuk ka kush në botë i cili nuk ka dëshirë me u bërë drejtor. Është diku një arsye që nuk ka kandidat aplikonte, andaj duhet me u bërë njëfarë analizë që me i gjetur shkaktarët.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja është se nuk duan me marrë përgjegjësi shtesë për një diferencë të vogël të pagës, ky është mendimi im, janë rrethanat e arsye të ndryshme, nuk mund të marrim këtë si studim.

z. Zahir Doda: Analizë nuk kam bërë, por rënia e mungesave dhe suksesit, një muaj me vonë ia ka filluar mësimi, këto janë çrregullime në sistemin mësimor që mësimi ka filluar me 1 muaj vonesë dhe unë sot e sjellin informatën 2 muaj pas vitit të ri, kjo nuk donë koment. Analiza për drejtorë të shkollave që punojnë me ushtrues detyre nuk kam bërë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj se kuvendi i Komunës
NJOFTOHET

Informatën për përfundimin e Gjysmëvjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023/ Lënda: 01Nr.04-610/01-3899/23.

Kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj të bëhet pauzë, ndërkaq pas pauzës vazhdohet me pikët vijuese:

5. Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Adnan Reka; Numri aktual i punëtorëve në vitin 2022 është 777. A duhet të jetë ky numër apo ky është numri me i vogël apo me i madh.

znj. Hidajete Guri: Sa i përket numrit të punësuarve me raport financiar është 777 punëtorë, i cili përfshinë, shëndetësinë, arsimin dhe administratë dhe zjarrfikësit. Sipas planifikimit buxhetor 2022, kemi numrin e lejuar për 804 punëtorë, mirëpo në fund të vitit është kjo shifër 777 punëtorë, me çka ndryshojnë se kemi zhvilluar një numër të konsiderueshëm të rekrutimit, por me arritur numrin e planifikuar 804, nuk kemi pasur mundësi për arsye të ndryshme, sepse gjatë vitit kemi pasur ndërprerje të marrëdhënies së punës, pensionime, përfundimit-skadimit të kontratave, sidomos në sektorin e arsimit, se shumë punëtorë punësohen me afat të caktuar, anulime të konkurseve, d.m.th. numri varion dhe asnjëherë nuk mundet me qenë shifra ashtu si e planifikojmë.

z. Adnan Reka: Nga numri i planifikuar 804 me atë ekzistues është 777 është 27 punëtorë, a është mundësi me u plotësuar kjo, por për arsye të ndryshme nuk mund të plotësohet?

znj. Hidajete Guri: Për arsye të ndryshme nuk ka mundësi me u plotësuar numri 804 punëtorë, kjo nuk mund të arrihet, për shkak se skadimi i kontratave mundet me u bërë brenda vitit dhe nuk bëhet përnjëherë. Ne mundemi me pasur në dhjetor skadim apo ndërprerje të kontratave për shkaqe të ndryshme, siç e potencova edhe me herët për shkak të pensionimit, ose dështojnë procedurat, ndërprerje të kontratave, anulim konkursi nga komisioni i ankesave apo të shumë

arsyeve tjera dhe nuk mundemi me mbërri numrin strikt të cilin e kemi planifikuar, ose shpallet ndonjë procedurë në fund të vitit dhe procedura vazhdon në vitin vijues. Në informatë janë të dhënat për të gjitha procedurat dhe nëse rritet numri i punëtorëve, atëherë rritet në janar të vitit vijues, nga 777 në janar 2023 janë shtuar 8 pozita. Duhet pasur të qartë se çështja e planifikimit nuk mund të arrihet asnjëherë strikt.

z. Adnan Reka: A ka një tolerancë plus minus, sa mund të jetë numri me i madh apo me i vogël nga ajo që planifikohet për të punësuarit brenda një viti.

znj. Hidajete Guri: Numri varion, mundem me paraparë sa pensionime janë brenda një viti, ndërkaq nuk mundem me paraparë për ndërprerje të marrëdhënies së punës me dëshirë, për të cilat duhet me zhvilluar procedura, pastaj kemi afatet ligjore për zhvillim të procedurave, 1 muaj është procedura e konkursit pastaj fillon aplikimi 15 ditë, kjo i bien 1 muaj e gjysmë, pastaj janë procedurat e selektimit etj. kemi raste kur në selektim na dështon procedura, në mungesë të dokumentacionit ose nuk kemi kandidat të mjaftueshëm, dhe duhet me u rishpallë konkursi dhe kjo merr kohë. Në vitin 2022 i kemi tejkaluar mundësitë që i kemi pasur, se ka pasur mundësi shifrat me qenë edhe me të vogla.

z. Adnan Reka: Atëherë sa po e kuptoj unë, nuk mundet me pasur limit sesa mundet me qenë numri nën atë që është planifikuar, mundet të jetë minus 50 apo 100. Të administrata janë 7 minus, të arsimit 4 minus, të shëndetësia 4 minus.

znj. Hidajete Guri: Të shëndetësia kanë dështuar vetëm 2 procedura nga komisioni i ankesave janë anuluar, ndërkaq janë plotësuar 7 pozita.

z. Adnan Reka: Numri aktual i punëtorëve të shëndetësia është 101, numri i planifikuar 105, në arsim numri i të punësuar 540, ndërkaq janë të punësuar 524.

Kryesuesi i Kuvendit: Janë çështje që varion brenda vitit, raporti bëhet për numrin që është në fund të vitit, pa llogaritur procedurat dhe çështjet tjera. Ky numër nuk mundet të kalojë shifrën e planifikuar, ndërsa nën atë shifër mundet varësisht nga mundësitë dhe çështjet të cilat rrjedhin gjatë vitit të çështja e kontratave. Të arsimit, drejtori është këtu dhe mundet me sqaruar numrin e të punësuarve.

z. Zahir Doda: Në arsim jemi të obliguar 3% të numrit të punëtorëve me lënë të lirë, përndryshe nuk mundem me i hequr nga lista punëtorin kur e zëvendëson dikush. Unë sa herë duhet me pasur 16 pozita të lira, se nëse bëhet një zëvendësim për pushim të lindjes, punëtori nuk hiqet nga lista e punësimit. Është mirë që asnjëherë nuk me ka mbetur jashtë liste asnjë punëtorë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Pyetje për udhëheqësen e personelit: Cili është kriteri kryesor i lejimit të pushimit pa pagesë dhe deri në çfarë afati kohor lejohet pushimi pa pagesë i të punësuarit ?

znj. Hidajete Guri: Në bazë të kriterëve të përcaktuara për pushime, është e përcaktuar lejimi i pushimit pa pagesë, ndërkaq varet për cilat arsye kërkon. Në qoftë se punëtori i plotëson kriteret e përcaktuara në rregullore, atëherë i lejohet pushimi pa pagesë, nëse jo i refuzohet kërkesa.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-1781/23.

6. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti është hartuar nga zyrtarja e KK, ku është bërë përmbledhja e aktiviteteve të KPF. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori,

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Raportin e punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-3910/22.

7. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo është një praktikë e re që po aplikohet për shkak të grantit të performancës. KK nuk ka obligim ligjor me aprovuar një raport të tillë, por po kërkoj ata që merren me grantin e performancës që raportet të diskutohen në KK. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Në bazë të këtij raporti, nuk janë paraqitur mostrat që është obligim ligjor me planin e prokurimit, KRPP dhe AQF. Duhet të publikohen në faqen e komunës raporti i auditorit, për me ditur të dhënat, sepse nuk ka raport të publikuar. Ky raport i jep mundësi qytetarëve që për çdo vit me pa planin dhe punën, aktivitetet për gjatë një viti. Nuk e di a e dini që duhet publikuar raporti i auditimit, apo me qëllim nuk e publikoni. Ky auditim edhe pse ka gjetur të shkelura dhe i ka paraqitur në kategori të ndryshme dhe janë dhënë rekomandime, janë përcjellë menaxhmentit nga njësia e auditimit, ndërkaq shumica janë diskutuar në menaxhment, ndërkaq menaxhmenti nuk ka pasur ndonjë plan për zbatimin e tyre. Çka keni marrë ju për menaxhimin e rekomandimeve, sepse nuk mundesh me gjetur asnjë kontratë për me ditur qytetari lidhur me to. Për atë, shprehi shqetësimet për të dhënat që i paraqitni në raport financiar.

Kryesuesi i Kuvendit: Komuna ka 2 raporte të auditimit, atë të auditimit të brendshëm dhe atë të auditimit të jashtëm. Raporti i zyrës kombëtare të auditimit është publik për qytetarët, sepse është një vlerësim i jashtëm. Zyra e auditimit të brendshëm funksionon në kuadër të zyrës kryetarit të komunës, e cila zyre duhet të njoftoj kryetarin me rrjedhjen e njësise organizative-komunës, me shkeljet të cilat ndodhin, që komuna të merr masa. Kjo është një kontroll e kryetarit ndaj organizatës, që kryetari të marr masa ndaj atyre shkeljeve. Raporti i auditimit të jashtëm, është një vlerësim i jashtëm i auditimit për të gjeturat e komunës, i cili raport debatohet në KK dhe bëhet plani për zbatimin e rekomandimeve sipas gjetjeve të auditorit. Raporti i auditimit të brendshëm është kryesisht për kryetarin, mirëpo pasi po kërkohet të debatohet edhe në KK, atëherë ne debatojmë për këtë çështje. Raporti i auditimit të jashtëm është ai që ne duhet t'i besojmë me tepër, po flas si anëtar i KK se ky raport i përket me tepër ekzekutivit të komunës, është edhe komiteti i Auditimit, e kam fjalën që mos të ndërldhim raportin e auditimit të brendshëm me atë të jashtëm, ndërkaq është mirë që të gjeturat në këto 2 raporte të përputhen, që mos të del çështja se auditori i brendshëm nuk i paska vërejtur ato të gjetura. Besoj njësia e auditimit të brendshëm është duke e kryer punën si duhet, është duke e njoftuar kryetarin me të gjeturat brenda organizatës buxhetore dhe kryetari merr masa për të gjeturat.

znj. Ardita Rrahmani: Referuar raportit të auditorit të brendshëm, shihet se të rekomandimet kemi një përqindje është 3.74% me të madhe nga viti i kaluar dhe nuk jemi të kënaqur me 34.78 % në zbatimin e rekomandimeve, ndërkaq kërkoj nga kryetari i komunës në bashkëpunim me ekzekutivin të rritë efikasitetin në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës

NJOFTOHET

Me Raportin vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 470/03-3974/23.

8. Propozim Vendimi për subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori

VENDIM

Për subvencionim e fermerëve/ Lënda: 01Nr. 08-320/01-388/23.

9. Propozim Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Shuma e cila është kalkuluar për subvencione në DKRS është afër 70,000€. A është miratuar me buxhet të vitit 2023 kjo shumë buxhetore. Nëse është marrë njëherë një vendim, atëherë cila është arsyeja me u marrë përsëri vendim për ndarje të subvencioneve ?

Kryesuesi i Kuvendit: Me buxhetin e vitit 2023 janë paraparë subvencionet, është miratuar me buxhet shuma totale për subvencione, në këtë rast propozimet dalin në KK për shpërndarjen e shumës së subvencioneve. Shpërndarja bëhet në bazë të rregullores për subvencione, ndërkaq OJQ duhet të konkurrojnë me projekte, se nuk dihet se cilat OJQ aplikojnë dhe me çfarë projektësh. Vlerësimi bëhet nga ana e komisioneve për OJQ që kanë aplikuar, dhe vijnë përsëri në KK për miratim. Kjo është procedurë që duhet ndjekur, se nuk mundet drejtorja me subvencionuar fjala vjen turneun e Shahut, pa e ditur a po mbahet turneu. Ky është një hap paraprak për me u ndarë këto mjete, pastaj drejtorja pas hapjes së thirrjes publike i njofton OJQ për projektet për subvencionim dhe në bazë të konkurrencës dhe mjeteve buxhetore, bëhet subvencionimi i tyre për ata që aplikojnë.

z. Agim Mani: Kërkoj një sqarim, pasi është vendimi paraprak për ndarjen e subvencioneve, në bazë të atij vendimi është dashur me bërë planin, se ne po marrim një vendim tani, pa pasur një plan për ndarjen e subvencioneve. Për hir të OJQ, ne LVV do të përkrahim këtë propozim vendim, se OJQ e meritojnë edhe me tepër.

Kryesuesi i Kuvendit: Kush përfiton nga subvencionet, varet nga konkurruesit dhe mjetet buxhetore, si total buxheti i ndarë për subvencione është të DKRS.

znj. Hafize Sallahi: Ne për këtë çështje kemi debatuar edhe në KPF, ku jemi thirrur në rregulloren 04/2017 të ministrisë, e cila i parasheh kriteret dhe standardet për ndarjen e subvencioneve. Është e vërtetë se shuma është miratuar si total, 70,000 €, por tani i ke të ndara për kulturë, rini dhe sport. Ne nuk mundemi me bërë plan të detajuar, se nuk e dimë OJQ me çfarë projektësh do të aplikojnë. Ne e kemi planin e punës së drejtorisë në kuadër të planit të ekzekutivit. Formohet një komision prej 5 anëtarëve i cili iu jep përparësi OJQ në bazë të projektit të cilin e dërgojnë, ndërkaq do të jetë edhe një komision tjetër i cili e monitoron ndarjen e subvencioneve, d.m.th gjithçka do të jetë shumë transparente në ndarjen e subvencioneve.

znj. Ardita Rrahmani: Thirrjet publike të cilat dalin nga DKRS, e ndiej për obligim ndaj vetës e në veçanti ndaj qytetarëve t'i bëjë thirrje-DKRS që t'i subvencionoj me tepër ato OJQ të cilat i sjellin rezultate me të mira komunës tonë.

z. Agim Çaka: Të pika 1.1 thuhet, lejohet shuma 19,500€ për mbështetje të OJQ në fushën e kulturës, ndërkaq të pika 1.3 i pikës 1. thuhet lejohet shuma 6,000 € në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Të pika 1.3 fusha është me e gjerë, ndërkaq shuma e mjeteve është e vogël për subvencione.

z. Agim Mani: Drejtoresha e përmendi një rregullore të ministrisë 04/2017, unë e kam lexuar atë rregullore, rregullorja thotë se duhet të jetë një plan transparentë.

Kryesuesi i Kuvendit: Plani transparentë është që drejtorja e ka ndarë shumën e mjeteve, me shumën e caktuar, 19.500€ të kultura, 44.500€ të rinia dhe sporti dhe 6,000€ të kultura, rinia dhe sporti. Plani transparentë bëhet edhe kur të ndahen këto shuma të mjeteve OJQ, të njëjtat do të vijnë në KK dhe do të bëhen transparente në faqen zyrtare të komunës. Komuna duhet të shikuar që secili subvencion që ndahet, a po shpenzohet për destinimin e caktuar, ku secila OJQ duhet të raportoj tek organet kompetente për shumën e mjeteve të shpenzuara nga subvencionet.

znj. Hafize Sallahi: Të shuma 6,000€ janë për subvencionim të aktiviteteve të paplanifikuara gjatë vitit. DKRS ka planin e punës për aktivitetet të cilat do t'i zhvilloj, por në ndërkohë mund të dal ndonjë kërkesë për ndonjë aktivitet nga ndonjë OJQ për e cila është e mirëseardhur për komunën. Këto bëhen me thirrje publike, ne nuk i dimë fushat ku do të jetë ndonjë kërkesë për aktivitete, për atë arsye është paraparë kjo shumë për ndonjë aktivitet i cili nuk është realizuar me parë, si p.sh. vjet e kishim një aktivitet për ditën e të moshuarve, e cila është mbajtur për herë të parë në Kaçanik, të cilat mjete janë ndarë me shpallje publike.

z. Agim Çaka: Të pika 1. 1 e vendimit, për rini e sport nuk ka të paraparë mjeteve, vetëm për kulturë, ndërsa të pika 1. 3 janë 6,000€ për kulturë rini dhe sport.

znj. Hafize Sallahi: Të këto 6,000€ kanë të drejtë aplikimi për ndonjë aktivitet të paplanifikuar që do të mbahet, ndërsa të shuma 19,500€, sivjet është një rritje se vjet janë ndarë 18,500€. Këtu hynë edhe organizimi 3 ditor i festivalit të fëmijëve dhe festivali tradicional që mbahet për nder të ditës së Çlirimit të Kaçanikut, ku aplikojnë SHKA -3 prej të cilave i kemi këtu, ndërkaq 44,500€ është për sport. Vjet i kishim 14 klube sportive që kanë aplikuar për këtë shumë, sivjet ka rritje, se janë formuar edhe klube tjera. Këto mjete nuk janë të mjaftueshme, por do të mundohemi me iu ndihmuar klubeve të cilat zhvillojnë aktivitete sportive.

z. Rustem Zenuni: Në raportin e DKRS mund t'i shohim se si janë ndarë subvencionet e kësaj drejtorie OJQ-ve.

z. Adnan Reka: Raporti financiar nga tregon për mjetet që janë shpenzuar, ndërkaq ne po duam me ditur si janë shpenzuar mjetet, ku kanë shkuar, se ne këtu nuk kemi asnjë plan se ku kanë me shkuar këto mjete.

Kryesuesi i Kuvendit: Në bazë të thirrjeve publike, shpenzohen mjetet, se përndryshe nuk e dimë as ne se ku kanë me shkuar këto mjete.

znj. Hafize Sallahi: Për me tepër, OJQ që do të përfitojnë, do të jenë të publikuara në faqen zyrtare të komunës, pas zhvillimit të procedurës së rregullt të ndarjes së tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë. Rezultati i votimit, me 25 votë për, Kundër votë nuk pati, Abstenoj Raif Kasa. Prezentë 26. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Lënda: 01Nr. 09-660/01-4005/23.

Kryesuesi i Kuvendit: E konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:37. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë, ndërkaq me lejen e Kryesuesit të KK, Besnik Salihu shkoj gjatë shqyrtimit të pikës së tretë.

Procesmbajtëse
Makfire Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 - Nr. *400/01-7056/23*
Kaçanik, 20.03.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjit Nr.08/L-193 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës Kaçanik,

Propozon Kuvendit Komunal këtë:

V E N D I M

PËR BARTJEN E MJETEVE VETANAKE TË PA SHPENZUARA NGA VITET PARAPRAKE NË BUXHETIN E KOMUNËS TË VITIT 2023

1.Me këtë Vendim, bëhet bartja e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2021 dhe 2022 në buxhetin e komunës të vitit 2023.

2.Shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2021 në vitin fiskal 2023 është 319,993.15 euro, ndërsa shuma e mjeteve për bartje nga viti fiskal 2022 në vitin fiskal 2023 është 496,629.52 euro. Totali i mjeteve të pashpenzuara nga vitet 2021 dhe 2022, të cilat kërkohen të barten në vitin 2023 është në shumë prej 816,622.67 euro.

3.Buxheti i Komunës së Kaçanikut i miratuar për vitin 2023 në shumë prej 10,674,689.00 euro, pas bartjes së mjeteve të pa shpenzuara nga vitet paraprake në shumë prej 816,622.67 euro, do të arrijnë shumën e përgjithshme prej 11,491,311.67 euro.

4.Mjetet e pa shpenzuara në shumë prej 816,622.67 euro, duke ruajtur strukturën e mbetjeve sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, janë planifikuar të barten si vijon:

- Mallra dhe Shërbime, shuma prej 827.78 euro;
- Shërbime Komunale, shuma prej16,500.00 euro;
- Subvencione dhe Transfere, shuma prej24,806.49 euro dhe
- Shpenzime Kapitale, shuma prej 774,488.40 euro.

5.Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë; Shtojcat A dhe B të pasqyrave tabelare e bilanceve të pa shpenzuara nga vitet fiskale 2021 dhe 2022 dhe rindarja e mjeteve të bartura në buxhetin e vitit 2023 në Nënprogramet përkatëse, kategoritë ekonomike dhe kodet e projekteve.

6.Për realizimin e këtij Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta përcjellë në Ministrinë e Financave Punes dhe Transfereve.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- 1.KPF
- 2.Kuvendi i Komunës, dhe
- 3.Arkivi.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

PASQYRA TABELARE
E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2021 DHE 2022
SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE

1/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2021

Tabela 1.

Nr.	Programet Buxhetore	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Planifikimi I Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-	-	-	-	30,000.00	30,000.00
2	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural-Nënprogrami 47028	-	-	-	4,148.20	-	4,148.20
3	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni-Nënprogrami 66445	-	-	-	-	29,570.63	29,570.63
4	Infrastruktura rrugore-nënprogrami 18028	-	-	-	-	211,006.08	211,006.08
5	Buxhetimi-Nënprogrami 17528	-	-	-	-	45,268.24	45,268.24
	T O T A L I :	-	-	-	4,148.20	315,844.95	319,993.15

2/. HVK-të e pa shpenzuara të vitit 2022

Tabela 2.

Nr.	Programet Buxhetore	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Planifikimi I Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-	-	-	8,721.94	33,633.40	42,355.34
2	Zyra e Kryetarit-Nënprogrami 16028	-	-	-	3,500.75	-	3,500.75
3	Çështjet gjinore-Nënprogrami 16528	-	0.72	-	-	-	0.72
4	Buxhetimi-Nënprogrami 17528	-	-	-	-	7,726.00	7,726.00
5	Zyra komunale për Komunitete-Nënprogrami 19640	-	15.00	-	-	-	15.00
6	Infrastruktura rrugore-nënprogrami 18028	-	-	-	-	87,288.79	87,288.79
7	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural-Nënprogrami 47028	-	-	-	6,784.00	3,443.26	10,227.26
8	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni-Nënprogrami 66445	-	-	-	-	51,652.71	51,652.71
9	Shërbimet e shëndetësisë primare-Nënprogrami 74700	-	-	15,000.00	-	-	15,000.00
10	Administrata dhe Personeli-Nënprogrami 16328	-	-	-	-	12,001.00	12,001.00
11	Kultura, rinia dhe spotet-Nënprogrami 85028	-	-	-	1,650.00	16,045.47	17,695.47
13	Arsimi parashkollorë-Nënprogrami 92750	-	812.06	1,500.00	-	-	2,312.06
14	Arsimi fillor, i mesëm i ulët-Nënprogrami 93810	-	-	-	1.60	4,840.38	4,841.98
	Pjesa e hvk te pa-alokuara	-	-	-	-	242,012.44	242,012.44
	T O T A L I :	-	827.78	16,500.00	20,658.29	216,631.01	496,629.52

C/. PËRMBLEDHJA (A+B) :

Tabela 3.

Nr.	Programet Buxhetore	Paga	Mallra dhe Sherbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Administrata dhe Personeli-Nënprogrami 16328	-	-	-	-	12,001.00	12,001.00
2	Zyra e Kryetarit-Nënprogrami 16028	-	-	-	3,500.75	-	3,500.75
3	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhv. Rural-Nënprogrami 47028	-	-	-	10,932.20	3,443.26	14,375.46
4	Buxhetimi-Nënprogrami 17528	-	-	-	-	52,994.24	52,994.24
5	Infrastruktura rrugore-nënprogrami 18028	-	-	-	-	298,294.87	298,294.87
6	Planifikimi I Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-	-	-	8,721.94	63,633.40	72,355.34
7	Çështjet gjinore-Nënprogrami 16528	-	0.72	-	-	-	0.72
8	Kultura, rinia dhe spotet-Nënprogrami 85028	-	-	-	-	16,045.47	16,045.47
9	Zyra komunale për Komunitete-Nënprogrami 19640	-	15.00	-	1,650.00	-	1,665.00
10	Arsimi parashkollorë-Nënprogrami 92750	-	812.06	1,500.00	-	-	2,312.06
11	Arsimi fillor, i mesëm i ulët-Nënprogrami 93810	-	-	-	1.60	4,840.38	4,841.98
12	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni-Nënprogrami 66445	-	-	-	-	81,223.34	81,223.34
13	Shërbimet e shëndetësisë primare-Nënprogrami 74700	-	-	15,000.00	-	-	15,000.00
14	Pjesa e hvk te pa-alokuara	-	-	-	-	242,012.44	242,012.44
	T O T A L I :	-	827.78	16,500.00	24,806.49	774,488.40	816,622.67

SHTOJCA - B : Rishpërndarja e mjeteve të bartura në 2023

**PASQYRA TABELARE
PËR RISHPERNDARJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË VITIT 2021 DHE 2022, NË VITIN 2023
(SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE KATEGORIVE EKONOMIKE TË SHPENZIMEVE)**

Tabela 4.

Nr.	Programet Buxhetore	Pagat	Mallra dhe Shërbime	Shërbime Komunale	Subvencione & Transfere	Investime Kapitale	Totali :
1	Zyra e Kryetarit-Nenprogrami 16028	-	-	-	24,806.49	-	24,806.49
2	Administrata dhe Personeli-Nënprogrami 16328	-	-	10,000.00	-	50,000.00	60,000.00
3	Bujqësia,Pylltaria dhe Zhv.Rural-Nënprogrami 47028	-	-	-	-	10,000.00	10,000.00
4	Shërbimet e shëndetësisë primare-Nenprogrami 74700	-	-	-	-	1,062.00	1,062.00
5	Shërbimet sociale Kaçanik-Nenprogrami 75636	-	-	-	-	30,000.00	30,000.00
6	Planifikimi i Zhvillimi Ekonomik, nënprogrami 48028	-	-	-	-	17,054.00	17,054.00
7	Infrastruktura rrugore-nënprogrami 18028	-	-	6,500.00	-	169,000.00	175,500.00
8	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni-Nënprogrami 66445	-	-	-	-	451,372.40	451,372.40
9	Arsimi parashkollorë-Nënprogrami 92750	-	827.78	-	-	-	827.78
10	Arsimi fillor,i mesëm i ulët-Nënprogrami 93810	-	-	-	-	46,000.00	46,000.00
T O T A L I :		-	827.78	16,500.00	24,806.49	774,488.40	816,622.67

► **SHPËRNDARJA E MJETEVE PËR INVESTIMEVE KAPITALE (22/300) SIPAS KODEVE EKONOMIKE DHE KODEVE TË PROJEKTEVE NË SHUMË**
TOTALE PREJ 774,488.40€, DO TË BËHET SIPAS KËSAJ PASQYRE TABELARE:

Tabela 5.

Nr.	INVESTIMET KAPITALE	Kodi Programit	Kodi i Projektit	Shuma :
1	Ndërtimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale	16028	50995	50,000.00
2	Ndërtimi i objektit të QMF-ës në fsh.Doganaj, faza III	74700	I ri	1,062.00
3	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik	66445	53198	51,618.00
4	Ndërtimi dhe funksionalizimi i objekteve për banim social	75636	51214	30,000.00
5	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat Biqec,Kovaqec dhe Dubravë	47028	52849	10,000.00
6	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriqimit publik në rrugën Murat Lika Shtrazë	48028	51648	17,054.00
7	Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike në lokalitetet (Kaçanik, Dubravë, Kaçanik i Vjetër, Ivajë, Shtrazë dhe Doganaj	18028	52879	42,000.00
8	Ndërtimi i objektit për Zjarrefiksesit - Kaçanik	18028	50170	80,000.00
9	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Begracë	18028	52174	15,000.00
10	Rregullimi i sheshit të qytetit - faza II-të	18028	51036	32,000.00
11	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave në lagjen Zeneli,Dema-Bob, Rakoc, Mejdi Dalloshi-qytet Kaçanik dhe në fshatin Stagovë.	66445	53133	33,754.40
12	Ndërtimi dhe rregullimi i Qarshisë së Vjetër të Qytetit	66445	51213	125,000.00
13	Ndërtimi i kulmit të SHFMU "Qamil Ilazi" K.Vjetër	93810	I ri	30,000.00
14	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike në SHFMU "Nazmi Osmani"	93810	50210	16,000.00
15	Ndërtimi i nënkalimit për këmbësorë nën hekurudhë në qytet	66445	I ri	241,000.00
Totali (1 deri 16) :				774,488.40



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATE/A:	07-104/01-7011 20. 03. 2023
PËR/ZA/TO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSELI, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	Besim ILAZI, kryetar i komunës
NGA/OD/FROM :	Ramadush OSMANI, drejtor i DSHPE-së
TEMA / SUBJEKAT/ SUBJECT:	Propozim-Vendimi për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave të Regjionit të Gjilanit dhe Ferizajit në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë **Propozim-Vendimin për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave të Regjionit të Gjilanit dhe Ferizajit në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.**

Qëllimi i bashkëpunimit ndërkomunal është përmirësimi i sektorit të menaxhimit të mbeturinave në komunat përkatëse përmes qasjes së menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Bashkëpunimi do të bëhet në bazë të reciprocitetit me qëllim që të ofrojë përfitime reciproke në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik.

Të bashkëngjitur keni: **Propozim-Vendimin për miratimin e Iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal në Regjionin e Gjilanit dhe Ferizajit.**

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Në bazë të nenit 12, nenit 28, nenit 29, nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, Kryetari i komunës së Kaçanikut propozon:

VENDIM

1. Për miratimin e Iniciativës për Bashkëpunim Ndërkomunal ndërmjet komunave përkatëse në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave:

- 2.1. Komuna e Gjilanit;
- 2.2. Komuna e Ferizajt;
- 2.3. Komuna e Kamenicës;
- 2.4. Komuna e Vitisë;
- 2.5. Komuna e Kaçanikut;
- 2.6. Komuna e Hanit të Elezit;
- 2.7. Komuna e Shtimes;
- 2.8. Komuna e Shtërpçës;
- 2.9. Komuna e Parteshit;
- 2.10 Komuna e Klllokotit
- 2.11 Komuna e Ranillugut
- 2.12 Komuna e Novobërdës

3. Kryetari i Komunës dhe Ekipi Ndërkomunal (i themeluar nga Kryetari, datë: 11.08.2022 me nr. prot. 01.Nr. 104/02-23163/22) janë të autorizuar të iniciojnë dialogun dhe të punojnë së bashku në hartimin e Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të identifikojnë implikimet e mundshme financiare duke përfshirë burimet e financimit për zbatimin e duhur të Planit. Kryetari i Komunës dhe ekipi ekzistues ndër-komunal mund të identifikojnë gjithashtu implikime të tjera të mundshme në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal në sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen e komunës së Kaçanikut.

Kryetari i komunës
Besim ILAZI



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Në bazë të nenit 6 paragrafi 2.1 dhe nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, në pajtim me nenin 12, nenin 28, nenin 29, nenin 40 dhe nenin 58 pika h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në pajtim me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Kryetarëve të Komunave të Regjionit të Gjilanit dhe Ferizajit, datë: 30.09.2022, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratim të:

INICIATIVËS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL NDËRMJET KOMUNAVE PËRKATËSE NË FUSHËN E SEKTORIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave në vijim:

- 1.1. Komuna e Gjilanit;
- 1.2. Komuna e Ferizajt;
- 1.3. Komuna e Kamenicës;
- 1.4. Komuna e Vitisë;
- 1.5. Komuna e Kaçanikut;
- 1.6. Komuna e Hanit të Elezit;
- 1.7. Komuna e Shtimes;
- 1.8. Komuna e Shtërpçës;
- 1.9. Komuna e Parteshit;
- 1.10. Komuna e Klllokotit;
- 1.11. Komuna e Ranillugut;
- 1.12. Komuna e Novobërdës

2. Qëllimi i bashkëpunimit ndërkomunal është përmirësimi i sektorit të menaxhimit të mbeturinave në komunat përkatëse përmes qasjes së menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Bashkëpunimi do të bëhet në bazë të reciprocitetit me qëllim që të ofrojë përfitime reciproke në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik.

3. Në përputhje me pikën 2 të kësaj nisme, dhe në përputhje me nenin 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Kryetarëve të Regjionit të Gjilanit dhe Ferizajit, palët bien dakord të bashkojnë përpjekjet në zhvillimin e Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve janë të përcaktuara në nenin 2 të Memorandumit të Mirëkuptimit.

4. Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe Ekipi Ndërkomunal (*i themeluar nga Kryetari, datë: 11.08.2022 me nr. prot. 01.Nr. 104/02-23163/22*) janë të autorizuar të punojnë së bashku në zhvillimin e Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave, të identifikojnë implikimet e mundshme financiare duke përfshirë burimet e financimit për zbatimin e duhur të Planit. Kryetari i Komunës dhe ekipi ekzistues ndërkomunal mund të identifikojnë edhe implikime të tjera të mundshme në lidhje me bashkëpunimin ndërkomunal.

5. Draft Plani i Integruar për Menaxhimin Ndërkomunal të Mbeturinave do të përgatitet në përputhje me Ligjin për Mbeturina dhe në përputhje me legjislacionin përkatës lidhur me procesin e politikëbërjes.

6. Kryetari i Komunës së Kaçanikut do të dorëzojë për miratim këto dokumente:

6.1. Draft Planin e Integruar për Menaxhimin Ndërkomunal të Mbeturinave;

6.2. Draft Marrëveshjen për Bashkëpunimin Ndërkomunal.

7. Bashkëngjitur kësaj iniciative:

7.1. Draft Vendimi për miratim të Iniciativës Komunale;

7.2. Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar në mes të komunave të Regjionit të Gjilanit dhe Ferizajit.

6. Arsyetimi:

Hartimi i Planit të Integruar Ndërkomunal për Menaxhimin e Mbeturinave krijon bazën për zbatimin e Sistemit Regional, ne pajtueshmeri me parimet themelore për menaxhimin e mbeturinave të përcaktuar në Direktivat e BE-së dhe në Ligjin për Mbeturina në lidhje me sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Këto parime përfshijnë menaxhimin e mbeturinave pa rrezikuar shëndetin e njeriut dhe pa dëmtuar mjedisin, pa rrezik për ujin, ajrin, tokën, bimët dhe kafshët, pa shkaktuar shqetësime nga zhurma ose aromat dhe pa ndikuar negativisht në zonat apo vendet me interes të veçantë. Themeli i Sistemit Regional do të jetë hierarkia e mbeturinave me pesë hapa, duke përfshirë parandalimin e mbeturinave si opsionin e parë, përgatitjen për ripërdorimin e mbeturinave që nuk mund të parandalohen, riciklimin dhe rikuperimin e fraksioneve të mbeturinave të ndara, në mënyrë që dërgimi i mbeturinave në deponi të jetë zgjidhja e fundit. Do të krijohet baza për zhvillimin e ekonomisë qarkore si

model prodhimi dhe konsumi që përfshin ndarjen, dhënien me qira, ripërdorimin, riparimin, rinovimin dhe riciklimin e produkteve dhe materialeve për aq kohë sa të jetë e mundur në mënyrë që cikli jetësor i produkteve të zgjerohet dhe të krijohet vlera e mëtejshme, ndërsa prodhimi i mbeturinave të reduktohet në minimum. Parimi ndotësi paguan do të zbatohet për mbulimin e kostos së sistemit të menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që kostoja për menaxhimin e mbeturinave të përballohen nga prodhuesit e mbeturinave ose nga mbajtësit e mbeturinave.

Drafti Plani i Integruar për Menaxhimin Ndërkomunal të Mbeturinave do të përmbajë të paktën temat në vijim, por pa u kufizuar në: gjendjen aktuale të sektorit për menaxhimin e mbeturinave; objektivat; opsionet dhe formën e bashkëpunimit; implikimet financiare dhe implikimet e tjera relevante për zbatimin e duhur të Planit; të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës komunë për zbatimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Draft Plani i Integruar për Menaxhimin Ndërkomunal të Mbeturinave do të përcaktojë kompetencat e komunave, opsionet për formën e bashkëpunimit në përputhje me nenin 9 të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë në ofrimin e shërbimeve dhe proceset e menaxhimit të mbeturinave në përgjithësi.

Plani i Integruar për Menaxhimin Ndërkomunal të Mbeturinave do të jetë pjesë e Draft Marrëveshjes Ndërkomunale që do t'i dorëzohet komunave përkatëse për miratim.

z. Besim Hazi
Kryetar i Komunë





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01Nr. 104/02-23163/22
Kaçanik, 11.08.22

Në mbështetje të neneve 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, me qëllim të inicimit të bashkëpunimit ndër-komunal për krijimin e bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Anmoravës, kryetari i komunës nxjerr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit teknik për krijimin e bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Anmoravës

- I. Me këtë vendim formohet grupi teknik për krijimin e bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Anmoravës
- II. Grupi teknik, do të ketë këtë përbërje:
 1. Afrim Fuga – zyrtar për menaxhimin e mbeturinave;
 2. Agron Dema -ekonomist;
 3. Izahir Kuka –zyrtar i prokurimit;
 4. Fadil Guri– zyrtar ligjor;
 5. Xhelal Ceka – udhëheqës i K.R.M “Pastërtia”- Njësia në Kaçanik;
- III. Grupi teknik obligohet që në bashkëpunim me ekipin e konsulentëve të GIZ-it dhe grupeve teknike të komunave të Anamoravës të filloj punën për krijimin e bazës për zbatimin e Sistemit Regjional të menaxhimit të Integruar të Mbeturinave në Regjionin e Anmoravës.
- IV. Grupi teknik për punën e vet, raporton te ekipi drejtues i komunës së Kaçanikut i formuar për krijimin e sistemit regjional të menaxhimit të integruar të mbeturinave, përmes bashkëpunimit ndër-komunal në Regjionin e Anamoravës,
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
- VI. Me këtë vendim, njoftohen: Anëtarët e grupit punues dhe Arkivi.



Besim Ilazi
Kryetari i Komunës

DRAFT MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR INICIMIN E MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE NË REGJIONIN E GJILANIT DHE FERIZAJT

Palë Nënshkruese të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë komunat: Gjilan, Ferizaj, Viti, Kacanik, Kamenicë, Hani Elezit, Shtime, Novobërdë, Shtërpce, Partesh, Kllokot, Ranillug

më tutje referuar si Palët.

PREAMBULE

Duke pasur parasysh që, Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Ligji Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkombëtar ofrojnë bazën ligjore për zhvillimin e planeve të përbashkëta komunale dhe për bashkëpunimin ndër-komunal;

Duke pasur parasysh që Palët kanë iniciuar procesin ndërlidhur me bashkëpunim me qëllim të krijimit të sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave në regjionin e Gjilanit dhe Ferizajt përmes hartimit të Planit Regjional për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (më tutje si "Plani Regjional") përmes të cilit do të definohet strategjia e përbashkët për menaxhimin e integruar të mbeturinave nga Palët, në përputhje me legjislacionin vendor në fuqi dhe me standarde Evropiane, si dhe objektivat e Strategjisë së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (2021- 2030);

Duke pasur parasysh që Bashkimi Evropian (BE) dhe Qeveria Gjermane, përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) janë duke ofruar mbështetje në përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë, duke përfshirë Regjionin, dhe do të vazhdojnë të ofrojnë mbështetjen e tyre për përmirësimin e shërbimeve bazë, drejt menaxhimit të integruar të mbeturinave në të ardhmen, si rezultat i realizimit të aktiviteteve të planifikuara tek Palët siç definohet me Plan Regjional;

Duke pasur parasysh që, dokumentet të cilat do të hartohen si rezultat i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të jenë bazë për themelimin e sistemit për menaxhimin e integruar të Mbeturinave, të cilat do të jenë të bazuara në parimet e përcaktuara nga Direktivat e BE-së dhe ligjet e aplikueshme të Kosovës për menaxhimin e Mbeturinave. Këto parime përfshijnë kërkesën për menaxhimin e mbeturinave pa rrezikuar shëndetin publik dhe pa dëmtuar mjedisin, si dhe pa rrezikuar ujin, tokën, bimët dhe kafshët, pa shkaktuar pengesa përmes zhurmës apo aromave dhe pa ndikuar në rrethin dhe vendet me interes të veçantë.

Bazat e sistemit regjional do të jetë hierarkia e mbeturinave me pesë hapa, duke përfshirë parandalimin e mbeturinave si opsioni i parë, përgatitjen për ripërdorimin e mbeturinave që nuk mund të parandalohen, riciklimin dhe rikuperimin e fraksioneve të mbeturinave të ndara, në mënyrë që dërgimi i mbeturinave në deponi të mund të jetë vetëm zgjidhja e fundit. Do të krijohen bazat për zhvillimin e ekonomisë qarkore si një model prodhimi dhe konsumi që përfshin ndarjen, dhënie me qira, ripërdorimin, riparimin, rinovimin dhe riciklimin e produkteve dhe materialeve për aq kohë sa të jetë e mundur, në mënyrë që cikli jetësor i produkteve të zgjatet dhe krijohet vlera e mëtejshme, ndërsa prodhimi i mbeturinave të reduktohet në minimum. Parimi ndotësi paguan do të zbatohet për mbulimin e kostove të sistemit të menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që kostot e

menaxhimit të mbeturinave të përballohen nga prodhuesit e mbeturinave ose nga mbajtësit e tyre.

Prandaj, Palët pajtohen me parimet dhe kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

- 1.1 Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është krijimi i kushteve bazë për Palët drejt themelimit të sistemit regjional për menaxhimin e integruar të mbeturinave (tutje referuar si sistemi regjional) përmes Bashkëpunimit Ndër-Komunal (tutje referuar si BNK)
- 1.2 Sistemi regjional do të dizajnohet dhe zbatohet në bazë të Planit të hartuar Regjional për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (tutje referuar si Plani Regjional) dhe në bazë të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndër-Komunal (tutje referuar si MBNK). Të dyja këto dokumente do të hartohen pas nënshkrimit të këtij MiM.

Neni 2

Përgjegjësitë dhe detyrat e Palëve

- 2.1 Me qëllim të arritjes së objektivave të këtij MiM, Palët pajtohen të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara mëposhtë:
 - 2.1.1 Orientimisht, brenda 30 ditëve të nënshkrimit të MiM delegojnë përfaqësuesit me qëllim të themelimit të Ekipit Ndër-Komunal;
 - 2.1.2 Orientimisht brenda 50 ditëve nga nënshkrimi i këtij MiM, Ekipit Ndër-komunal i ofrohen të gjitha të dhënat, informacionet dhe burimet e nevojshme për të hartuar Planin Regjional, planet komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe rregulloret komunale për menaxhimin e mbeturinave për të zbatuar planet e menaxhimit të mbeturinave në territoret komunale;
 - 2.1.3 Orientimisht brenda 180 ditëve nga nënshkrimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, Palët do të hartojnë Planin Regjional në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbeturinat dhe do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për miratimin e Planit në kuvendin komunal të secilës nga Palët;
- 2.2 Përveç pjesës përmbajtësore të planeve për menaxhimin e mbeturinave, të përcaktuara në nenin 10 të Ligjit për Mbeturinat, do të merren parasysh dhe përfshihen çështjet e mëposhtme me prioritet në Planin Rajonal:
 - 2.2.1 Detyrat dhe përgjegjësitë që do të zbatohen bashkërisht dhe individualisht nga komunat;
 - 2.2.2 Përcaktimi i modelit të bashkëpunimit ndër-komunal në aspektin e strukturave udhëheqëse dhe në aspektin e ofrimit të shërbimeve;
 - 2.2.3 Nevoja për themelimin e një strukture të përbashkët juridike për qëllime të bashkëpunimit ndër-komunal dhe ndikimi në strukturat aktuale subjektet juridike;
 - 2.2.4 Identifikimi i statusit juridik të përshtatshëm të njësisë së përbashkët, procesi i themelimit të njësisë së përbashkët, procedurat e vendimmarrjes dhe çështje të tjera që ndërlidhen me udhëheqjen, themelimin dhe menaxhimin e strukturës së përbashkët;

- 2.2.5 Implikimet financiare të modeleve të bashkëpunimit ndër-komunal, pjesa e investimeve, financat, të drejtat dhe përgjegjësitë;
 - 2.2.6 Vlerësimi i opsioneve për pjesëmarrje nga sektori privat (ofruesit privat të shërbimeve dhe PPP), hartimi i dokumenteve kontraktuale të aplikueshme;
 - 2.2.7 Opsionet e financimit të sistemit të integruar të menaxhimit të mbeturinave, llogaritja, vendosja dhe mbledhja e tarifave të përdoruesit (tarifave), zbatimi i një sistemi të përbashkët faturimi;
 - 2.2.8 Masat për monitorimin dhe vlerësimin e bashkëpunimit ndër-komunal;
 - 2.2.9 Hartimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ndër-komunal, në përputhshmëri me Nenin 8 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër-Komunal, e cila, inter-alia, do të përfshijë edhe procedurën për vendim-marrje;
 - 2.2.10 Detajet për zbatimin e procedurës së përcaktuar në nenin 6 dhe nenin 7 të Ligjit për bashkëpunim ndër-komunal mbi iniciativën për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal.
- 2.3 Palët pajtohen që të ndjekin procedurat e rregullta për iniciimin e BNK, në përputhshmëri me Nenin 6 të Ligjit për Bashkëpunim Ndër-Komunal:
- 2.3.1 Të paraqesin iniciativën për BNK në kuvendet respektive komunale, në përputhshmëri me afatet më të arsyeshme kohore, gjithnjë duke pasur parasysh afatin orientues kohor prej 180 ditësh i cili kërkohet për aprovim nga kuvendet komunale nga dita e paraqitjes së iniciativës me shkrim për BNK;
 - 2.3.2 Të paraqitet për aprovim në kuvendet respektive komunale Planin Regjional dhe IBNK, së bashku me dokumentet tjera relevante dhe të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për marrjen e aprovimit;
 - 2.3.3 Të harmonizohen planet komunale dhe rregulloret komunale së bashku me Planin Regjional, jo më vonë se 60 ditë pas aprovimit të Planit Regjional.

Neni 3

Ekipi ndër-komunal

3.1 Ekipi Ndër-komunal do të përbëhet nga dy nën-strukturat e mëposhtme:

- 3.1.1 Ekipi drejtues do të përbëhet nga kryetarët e komunave dhe kryesuesit e kuvendeve komunale të Palëve përgjegjëse për zhvillimin e negociatave lidhur me marrjen e vendimeve ndër-komunale, prezantimin dhe marrjen e miratimeve nga kuvendet komunale dhe drejtimin e Ekipit Ndër-komunal.
- 3.1.2 Ekipi teknik do të përbëhet nga drejtorët e drejtorive kompetente, zyrtarët komunal për menaxhimin e mbeturinave, zyrtarët financiarë, zyrtarët e prokurimit, zyrtarët ligjorë, kryeshefat ekzekutivë të ndërmarrjeve publike që operojnë në menaxhimin e mbeturinave dhe çdo përfaqësues tjetër të Palëve, kualifikimet dhe/ose përvoja e të cilëve janë konsiderohet e rëndësishme për arritjen e objektivave të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, të cilët do të jenë përgjegjës për hartimin e dokumenteve të kërkuara, paraqitjen e të dhënave, informacionit dhe dokumenteve tek Ekipi Drejtues, ndërmarrjen e detyrave të tjera të caktuara nga Ekipi Drejtues sipas nevojës për të arritur objektivat e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

3.2 Për realizimin e mbledhjeve të Ekipit Ndër-komunal, Palët, me rotacion do të ofrojnë hapësirën e nevojshme për mbledhjet e rregullta të Ekipit Ndër-komunal, të cilat do të mbahen si në vijim. Ekipi Teknik do të ketë mbledhje të rregullta çdo dy javë dhe mbledhje *ad hoc* sipas kërkesës, ndërsa ekipi drejtues do të ketë mbledhje të rregullta mujore dhe mbledhje *ad hoc* sipas kërkesës. Palët do të kryesojnë mbledhjet sipas parimit të rotacionit, dhe do të marrin përsipër rolin e Sekretariatit për të caktuar mbledhjet, për të përgatitur procesverbalet e mbledhjeve, për të shpërndarë procesverbalet dhe dokumentet e tjera përkatëse tek pjesëmarrësit dhe palët e tjera të interesuara (nëse vendoset kështu në mbledhje), dhe për të koordinuar zbatimin e vendimeve të formuluar në procesverbal.

3.3 Palët kanë të drejtë të kërkojnë mbështetje të jashtme teknike dhe financiare, nëse kjo është e domosdoshme, nga palët përkatëse të interesuara, organet e pushtetit qendror apo organizata ndërkombëtare.

Neni 4

Vlefshmëria

4.1 Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët dhe do të mbetet në fuqi deri në arritjen e objektivave të përcaktuara me këtë Memorandum.

4.2 Palët nënshkruese e pranojnë dhe bien dakord me këtë Memorandum Mirëkuptimi, i nënshkruar me 30 shtator 2022



Alban Hyseni, Kryetar

Komuna e Gjiçanit



Sokol Haliti, Kryetar

Komuna e Vitisë



Agim Aliu, Kryetar

Komuna e Ferizajt



Besim Ilazi, Kryetar

Komuna e Kacanikut



Mehmet Ballazhi, Kryetar

Komuna e Hanit te Elezit



Kadri Rahimaj, Kryetar

Komuna e Kamenices



Qemajl Aliu, Kryetar

Komuna e Shtimes



Dalibor Jevtic, Kryetar

Komuna e Shterpces



Dragan Petkovic, Kryetar

Komuna e Parteshit



Katarina Ristic-Ilic, Kryetare

Komuna e Ranillugut



Vladan Bogdanovic, Kryetar

Komuna e Klokotit



Sasa Milosevic, Kryetar

Komuna e Novoberdes



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosova




REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	21.03.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.		Numri	
	01		60/01-7136

KAÇANIKU



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

KOMITETI KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Data:	15.03.2023
Nr.protokolit:	
Për:	z. Kemal Murseli, Kuvendi Komunal Kaçanik
CC:	
Përmes:	znj. Makfire Malsiu, Zyrtare e lartë në Kuvendin Komunal
Nga:	Komiteti Konsultativ për PAK
Lënda:	Dorëheqje

KËRKESË

Anëtarët e Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të kufizuara, Antigona Axhami Baftijaj, Fiknete Krasniqi si dhe Edita Shehu bëjnë kërkesë për dorëheqje nga komiteti për arsye se kanë mbetur vetëm 3 (tre) anëtarë në komitet dhe është e pamundur që të mbahen mbledhjet vetëm me këto anëtarë.

Me respekt!

Anëtarët:

Antigona Baftijaj 

Fiknete Krasniqi _____

Edita Shehu 